



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo

Qeveria/Vlada/Government

Ministria e Punëve të Jashtme/Ministarstvo Inostranih Poslova/Ministry of Foreign Affairs

Akademia Diplomatike/Diplomatska Akademija/Diplomatic Academy

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet

Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës

dhe

**Qendrës për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë,
Partner i Institutit Goethe**

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë, Partner i Institutit Goethe, (në vazhdim të tekstit referuar si **Palët Nënshkruese**) pajtohen si në vijim:

Neni 1

Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë ofron kurse të mësimin të gjuhës gjermane për 16 zyrtarë të Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës, për nivele dhe periudhë kohore si në vijim:

1. Kurs për nivelin A1.1 nga 23.02. deri me 08.05.2015

dhe

2. Kurs për nivelin A1.2. nga 11.05. deri me 24.07.2015

Secili nivel i kurseve përfshinë 44 orë mësimi në kohëzgjatje prej 45 minutave për 16 kursistë (ne tekstin e mëposhtem “Kursi”). Orët e mësimin do të mbahen gjatë dy ditëve të punës brenda çdo jave. Orët e mësimin do të mbahen në hapësirat e Akademisë Diplomatike.

Neni 2


Palët nënshkruese u morën vesh që tarifa për Kurs të ofrohet me zbritje prej 50%, dhe se tarifa e tillë pas zbritjes për secilin Kurs të jetë 1023,20 €. Ky çmim përfshinë poashtu edhe librat e destinuar për nivelin e kursit (librin e kursit dhe librin e punës).

Neni 3

Palët nënshkruese u morën vesh që pas pjesëmarrjes së suksesshme në Kursin A1.2, vijuesit e kurseve mund të marrin pjesë në provimin e njohur ndërkombëtarisht **Start Deutsch 1** të **Institutit Goethe**. Për pjesëmarrjen në provimin e lartcekur, vijuesit e kurseve do të paguajnë 50% të tarifës zyrtare për provim, të vendosur nga organizuesi i provimeve.

E lidhur në Prishtinë, më 12 shkurt 2015, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane.


Për Akademinë Diplomatike të
Republikës së Kosovës



Skender Durmishi

Drejtor i Akademisë Diplomatike

Për Qendrën për Mësimin e
Gjuhës në Prishtinë, Partner i
Institutit Goethe



Annamaria Farkas-Mecinaj

Drejtoreshë e Qendrës për Mësimin
e Gjuhës në Prishtinë,
Partner i Institutit Goethe